



Udhëzues për Konsultimin Deliberativ në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë

Përgatitur nga

Prof. Asoc. Dr. **Elona Dhëmbo**

Eksperte e angazhimit qytetar dhe lektore në Universitetin e Tiranës

Recensuan

Sarah Allan dhe **Carly Walker-Dawson**

Involve UK

PËRMBAJTJA

1. HYRJE: KONTEKSTI DHE QËLLIMI I DOKUMENTIT	5
2. ANGAZHIMI I PUBLIKUT NË VENDIMMARRJE – ÇFARË ËSHTË DHE PSE SHËRBEN?	6
2.1 PËRFITIMET E DEMOKRACISË DELIBERATIVE	7
2.2 PARIMET KRYESORE TË DEMOKRACISË DELIBERATIVE	7
2.3 ANGAZHIMI DELIBERATIV KUNDREJT ATIJ PJESËMARRËS	7
3. TË DREJTAT DHE DETYRIMET	10
4. PËRKUFIZIMI DHE KUPTIMI I PJESËMARRJES	11
4.1 PËRKUFIZIMI DHE TIPARET E PJESËMARRJES	11
5. SPEKTRI I PJESËMARRJES DHE KRIJIMI I MUNDËSIVE	12
6. CIKLI I PJESËMARRJES	15
7. MUNDËSITË PËR ANGAZHIM DHE PJESËMARRJE ME KUVENDIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË	16
7.1 MUNDËSI PËR ANGAZHIM ME KUVENDIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË	16
7.2 ZHVILLIMI I PRAKTIKAVE GJITHËPËRFSHIRËSE TË ANGAZHIMIT TË QYTETARËVE	16
8. PRAKTIKA TË MIRA	19
9. ZHVILLIMI I STRATEGJIVE DHE PRAKTIKAVE EFEKTIVE DHE GJITHËPËRFSHIRËSE PËR ANGAZHIM DHE PJESËMARRJEN	29
10. KONKLUZION & HAPA TË MËTEJSHËM	30
11. BURIME	31

1. HYRJE: KONTEKSTI DHE QËLLIMI I DOKUMENTIT

Në një demokraci funksionale, angazhimi aktiv i qytetarëve në proceset vendimmarrëse është thelbësor për t'u siguruar që politikat dhe ligjet reflektojnë nevojat dhe aspiratat e shoqërisë. Ky udhëzues synon të lehtësojë përpjekjet e Kuvendit të Shqipërisë në krijimin e mekanizmave efektivë për të mundësuar dhe inkurajuar pjesëmarrjen e qytetarëve në punën e tij, duke forcuar kështu lidhjen midis institucionit dhe publikut.

Ky dokument është zhvilluar në kuadër të projektit “Rritja e reagimit të Kuvendit ndaj shqetësimeve të qytetarëve”, zbatuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) me mbështetjen e Qeverisë Britanike.

Dokumenti është konceptuar si një burim reference, por dhe si një material praktik dhe gjithpërfshirës për çështjet kryesore që lidhen me parimet dhe praktikën e demokracisë deliberative. Ai fillon duke shqyrtuar disa nga përkufizimet, parimet dhe arsyet që mbështesin angazhimin qytetar. Ai vazhdon me eksplorimin e mundësive për përfshirjen e publikut në proceset parlamentare dhe paraqet një sërë metodash, raste e praktika të mira të përdorimit të tyre nga parlamentet. Raporti përfundon duke identifikuar sfidat e ardhshme dhe duke dhënë rekomandime për përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet Kuvendit, shoqërisë civile dhe publikut.

2. ANGAZHIMI I PUBLIKUT NË VENDIMMARRJE – ÇFARË ËSHTË DHE PSE SHËRBEN?

Angazhimi i publikut në vendimmarrje i referohet proceseve ku një institucion, si Kuvendi i Shqipërisë, kërkon të angazhojë aktivisht anëtarë të publikut për të ndikuar dhe ndihmuar në formësimin e punës së tij. Shembujt të angazhimit të qytetarëve përfshijnë disa forma, që nga komisionet parlamentare, kontributi publik në procesin legjislativ, tek sistemet e peticioneve dhe iniciativat e qytetarëve.

Angazhimi publik në vendimmarrje është një element plotësues, shumë i rëndësishëm, i punës jetike të vetë deputetëve në angazhimin me votuesit dhe në përpjekjet për përfaqësimin e tyre. Ai u mundëson atyre të kontaktojnë dhe marrin nga anëtarët e publikut:

- Njohuri (p.sh. për zonën e tyre ose për një temë të caktuar);
- Përvoja (p.sh. të një shërbimi të caktuar ose rrethanave jetësore);
- Pikëpamje (p.sh. shqetësimet, aspiratat, preferencat, prioritetet); dhe/ose
- Ide.

Angazhimi i publikut në këto procese mundëson kontribute të vlefshme për institucionet në zhvillimin e politikave dhe iniciativave efektive për të përmbushur synimet e tyre me mbështetjen e publikut. Format e ndryshme të angazhimit dhe kontributit ndihmojnë institucionet të identifikojnë problemet që duhet të adresohen dhe të ndërtojnë besimin e publikut.

Manuali i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje, i publikuar në vitin 2022, thotë se:

" Pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje është element thelbësor për çdo sistem politik transparent, të përgjegjshëm dhe demokratik. Pjesëmarrja në veprimtarinë e Kuvendit e sjell publikun më pranë përfaqësuesve të tyre, krijon mundësinë që ata të adresojnë probleme e të ofrojnë zgjidhje të përshtatshme për to, të analizojnë e vlerësojnë rezultatet e zbatimit të politikave, si dhe të mbikëqyrin veprimtarinë e të zgjedhurve të tyre. Ajo merr rëndësi të veçantë kur diskutohen çështje që kanë të bëjnë me grupe në nevojë, si: personat me aftësi të kufizuar, gratë, fëmijët, minoritetet, etj."¹

Siç pranohet edhe në citimin e mësipërm, angazhimi publik ka vlerë të veçantë në lidhje me grupet e marginalizuara ose pakicat. Shpesh, këta njerëz dhe komunitete janë të nën-përfaqësuar brenda institucioneve, ose mungojnë tërësisht brenda tyre. Prandaj, zhvillimi i proceseve që mundësojnë angazhim e që funksionojnë për ta është thelbësor për të trajtuar diskriminimin dhe për të siguruar që pikëpamjet, nevojat dhe aspiratat e tyre të pasqyrohen siç duhet në vendimet që merren. Pra, angazhimi i publikut në vendimmarrje, mund të ofrojë një gamë të gjerë përfitimesh, si për Kuvendin e Shqipërisë, ashtu edhe për qytetarët shqiptarë, përfshirë grupet e marginalizuara dhe pakicat.

1 Shiko: MANUAL I PJESËMARRJES SË PUBLIKUT NË PROCESIN VENDIMMARRËS TË KUVENDIT 2022, [https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/Manual%20Pjese%CC%88marrjes%20se%CC%88%20Publikut%20ne%CC%88%20Procesin%20Vendimmarrjes%20te%CC%88%20Kuvendit%20-%20Copy%20\(2\).pdf](https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/Manual%20Pjese%CC%88marrjes%20se%CC%88%20Publikut%20ne%CC%88%20Procesin%20Vendimmarrjes%20te%CC%88%20Kuvendit%20-%20Copy%20(2).pdf) faqe 7.

2.1 PËRFITIMET E DEMOKRACISË DELIBERATIVE

Demokracia deliberative fokusohet në diskutimin dhe reflektimin e përbashkët për çështje publike, duke synuar arritjen e vendimeve të informuara dhe legjitime.

Dhënia prioritet çështjeve të demokracisë deliberative është thelbësore, sepse ajo ndihmon të sigurohemi se vendimmarrja nuk orientohet vetëm nga rezultatet, por edhe nga legjitimiteti dhe gjithëpërfshirja në proces. Duke vendosur theksin tek dialogu i arsyetuar, hapja dhe llogaridhënia, demokracia deliberative përputhet me parimet themelore të institucioneve demokratike. Institucionalizimi në rritje i praktikave deliberative në demokracitë e zhvilluara tregon për rëndësinë e saj. Integrimi i metodave deliberative në hartimin e politikave forcon legjitimitetin, rrit besimin e publikut dhe siguron që politikat të jenë të informuara nga perspektiva të ndryshme.

Që të jetë efektive, demokracia deliberative duhet të ketë burime të mjaftueshme, të jetë transparente dhe llogaridhënëse, duke siguruar pjesëmarrje të gjerë, veçanërisht të zërave të pakicave apo të disavantazuarve, dhe një proces të vazhdueshëm të të mësuarit për përmirësimin e këtyre proceseve. Prandaj, prioritetizimi i demokracisë deliberative është thelbësor për ta bërë qeverisjen më pjesëmarrëse, gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme.

Më konkretisht, përfitimet kryesore që vijnë nga ushtrimi i demokracisë deliberative përfshijnë:

- **Vendimmarrje më të informuar:** Përfshirja e qytetarëve në diskutime të thelluara çon në vendime që pasqyrojnë një kuptim më të plotë të çështjeve.
- **Rritje besimi në institucione:** Kur qytetarët ndihen të dëgjuar dhe të përfshirë, besimi i tyre në institucionet demokratike rritet.
- **Forcimi i kohezionit social:** Diskutimet e hapura dhe gjithëpërfshirëse promovojnë mirëkuptimin dhe respektin ndërmjet grupeve të ndryshme shoqërore.

2.2 PARIMET KRYESORE TË DEMOKRACISË DELIBERATIVE

Që të mirë-funksionojë, demokracia deliberative duhet të udhëhiqet nga disa principe kryesore si barazia, transparenca, respekti për diversitetin dhe racionaliteti.

- **Barazia:** Çdo pjesëmarrës duhet të ketë mundësi të barabarta për të kontribuar në diskutim.
- **Transparenca:** Proceset dhe informacionet duhet të jenë të hapura dhe të aksesueshme për të gjithë.
- **Respekti për diversitetin:** Njohja dhe vlerësimi i perspektivave të ndryshme në shoqëri.
- **Argumentimi racional:** Përdorimi i argumenteve të bazuara në evidenca për të ndikuar në vendimmarrje.

2.3 ANGAZHIMI DELIBERATIV KUNDREJT ATIJ PJESËMARRËS

Ka shumë mënyra për të kategorizuar llojet e ndryshme të angazhimit publik në vendimmarrje. Një dallim kyç është ai ndërmjet metodave të angazhimit deliberativ (diskutues) dhe atyre pjesëmarrëse. Edhe pse vija ndarëse mes këtyre të dyjave është e hollë dhe shpesh jo e qartë, mund të ofrohen disa konstatime të përgjithshme mbi diferencat mes tyre.

Në thelb, të dyja këto metoda nuk janë detyruesisht njëra më të mira se tjetra. Megjithatë, ato ofrojnë përfitime të ndryshme dhe janë të përshtatshme për situata të ndryshme.

2.3.1 METODAT DELIBERATIVE

Metodat deliberative (ose diskutuese) fokusohen në thellësinë dhe cilësinë e angazhimit.

Çfarë përfshijnë ato? Ato përfshijnë bashkimin e njerëzve virtualisht (në internet) ose personalisht që (1) të mësojnë për një temë të caktuar nga njëri-tjetri dhe/ose nga informacione shtesë që ofrohen, (2) të peshojnë me kujdes dhe kolektivisht atë informacion që marrin dhe atë që ata mendojnë, dhe (3) të arrijnë një përfundim të përbashkët.

Kush merr pjesë? Njerëzit që marrin pjesë shpesh zgjidhen rastësisht, për të pasqyruar popullsinë në tërësi për sa i përket demografisë, gjeografisë dhe ndonjëherë edhe qëndrimeve ose sjelljeve të tyre, duke krijuar atë që njihet si Mini-Publik Deliberativ (MPD). Përgjithësisht, kjo është shumë efektive për të arritur tek njerëzit që zakonisht nuk janë aktivë në politikë.

Sa persona marrin pjesë? Ngjarjet e angazhimit konsultativ priren të përfshijnë një numër relativisht të vogël njerëzish (diku midis 15 deri në disa qindra) si pjesëmarrës të drejtpërdrejtë, megjithëse një numër shumë më i madh njerëzish mund të arrihet përmes një kontakti më të gjerë përpara, gjatë dhe pas vetë ngjarjeve/aktiviteteve të angazhimit.

Si mund të ndihmojnë ata? Siç u përmend tek përfitimet e përshkruara më sipër, metodat deliberative i lejojnë deputetët të kuptojnë se ku njerëzit mund të gjejnë gjuhën e përbashkët, ku nuk mundën dhe pse, në vend që të dëgjojnë vetëm nga individë dhe grupe me këndvështrime shumë të ndryshme. Ato i lejojnë deputetët të kenë qasje në gjykimin dhe preferencat e informuara të publikut për tema komplekse, duke u mundësuar atyre të vlerësojnë më mirë forcën dhe drejtimin e vullnetit të publikut për veprim, ose mosveprim.

Cilët janë disa shembuj? Seksioni 8 i këtij udhëzuesi përfshin përshkrime dhe raste studimore të dy metodave deliberative - paneleve të qytetarëve dhe workshopeve konsultative. Shembuj të tjerë të metodave deliberative të përdorura nga parlamentet përfshijnë, për shembull, asamblëtë e qytetarëve dhe juritë e qytetarëve. Shih për shembull Asamblenë Qytetare për Abortin e krijuar nga Parlamenti Irlandez në përputhje me programin e qeverisë², ose Asamblenë Qytetare për Kujdesin Social të drejtuar nga dy komisione të Dhomës së Komunave.

2.3. METODAT PJESËMARRËSE

Metodat pjesëmarrëse priren të përqendrohen në mundësimin e një numri më të madh njerëzish që marrin pjesë në proces, megjithëse ato mund të funksionojnë edhe me një numër më të vogël njerëzish.

Çfarë përfshijnë ato? Ato mund të marrin një gamë të gjerë formash të ndryshme, nga metodat që angazhojnë njerëzit si individë (si pyetësorët ose intervistat), deri tek metodat që bashkojnë grupe njerëzish në mënyra që janë disi më pak të thelluara sesa ekuivalentet e tyre deliberative (si për shembull 'Dialogjet e Shpërndara' dhe 'Hapësira e Hapur e Teknologjisë'). Metodatat pjesëmarrëse priren të mos dalin me një përfundim të përbashkët, ashtu siç bëjnë metodat deliberative.

Kush merr pjesë? Metodatat pjesëmarrëse priren të përqendrohen te njerëzit me përvoja të veçanta jetësore (p.sh. të qenit prind, të qenit me një aftësi të kufizuar etj.) dhe/ose njerëzit që zgjedhin vetë t'i përgjigjen thirrjeve të hapura për informacion ose ide.

Sa persona marrin pjesë? Metoda të tilla si anketat mund të arrijnë mijëra persona. Ndërsa ngjarje si 'Hapësira e Hapur e Teknologjisë' (Open Space Technology) mund të funksionojnë me rreth 30 persona e lart.

2 [https://en.wikipedia.org/wiki/Citizens%27_Assembly_\(Ireland\)](https://en.wikipedia.org/wiki/Citizens%27_Assembly_(Ireland))

Si mund të ndihmojnë? Për sa i përket përfitimeve të përshkruara në seksionin 2.1, metodat pjesëmarrëse priren të përqendrohen tek ofrimi i mënyrave të shpejta për deputetët që të shfrytëzuar njohuritë, përvojat, pikëpamjet dhe idetë e anëtarëve të publikut bazuar në përvojat e tyre jetësore, duke lejuar identifikimin e problemeve dhe zhvillimin e zgjidhjeve efektive për to. Ato gjithashtu mund të jenë të përshtatshme për angazhimin e pakicave dhe grupeve të marginalizuara, si dhe të atyre që normalisht nuk angazhohen, duke ndihmuar në adresimin e diskriminimit dhe përjashtimit.

Cilët janë disa shembuj? Seksioni 8 i këtij udhëzuesi përfshin përshkrime të një sërë metodash pjesëmarrëse, duke përfshirë 'Hapësira e Hapur e Teknologjisë', Ngjarjet Piramidë, Hulumtimin e Qytetarëve, Sondazhet, Dialogjet e Shpërndara, Crowdsourcing Online, Vizitat dhe Intervistat Gjysmë të Strukturuara, etj.

3. TË DREJTAT DHE DETYRIMET

Çdokush ka të drejtën të marrë pjesë në proceset që çojnë në vendime të cilat ndikojnë te të drejtat e njeriut që ata duhet të gëzojnë. Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike është thelbësore për fuqizimin e individëve dhe grupeve. Ajo është e domosdoshme për eliminimin e marginalizimit dhe diskriminimit. Kjo e drejtë është e pandashme nga të drejtat e tjera të njeriut, si p.sh. nga e drejta për lirinë e mendimit dhe shprehjes, e drejta për tubim dhe organizim paqësor etj.

Kushtetuta e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi garantojnë të drejtat themelore të njeriut, përfshirë të drejtën për pjesëmarrje në jetën publike. Detyrimet ligjore përfshijnë:

- **Sigurimin e mundësive të barabarta:** Institucionet publike duhet të sigurojnë që të gjithë qytetarët, pavarësisht prejardhjes, gjinisë apo statusit social, të kenë mundësi të barabarta për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse.
- **Respektimin e të drejtave të njeriut:** Çdo proces pjesëmarrës duhet të respektojë dinjitetin dhe të drejtat themelore të individëve, pavarësisht përkatësive të tyre.
- **Transparenca dhe llogaridhënia:** Institucionet janë të detyruara të jenë transparente në veprimet e tyre dhe të japin llogari për vendimet e marra.

4. PËRKUFIZIMI DHE KUPTIMI I PJESËMARRJES

4.1 PËRKUFIZIMI DHE TIPARET E PJESËMARRJES

Pjesëmarrja është një term ombrellë që përdoret për të përshkruar mënyrën se si njerëzit angazhohen në procese vendimmarrje që i prekin ose janë të rëndësishme për ta.

Metodat deliberative dhe pjesëmarrëse funksionojnë në mënyra të ndryshme. Megjithatë, ka disa parime që janë të përbashkëta për të gjitha format e angazhimit publik në procesin e vendimmarrjes. Ato kërkojnë që pjesëmarrja/angazhimi të jetë:

- **Domethënës** – të ekzistojë një dëshirë e sinqertë për t'u dhënë njerëzve mundësinë të informojnë ose të ndikojnë në procesin e vendimmarrjes, dhe rezultatet e angazhimit përdoren për këtë qëllim;
- **I synuar** – procesi duhet të mendohet me kujdes se kë duhet të arrijë angazhimi për t'iu përgjigjur pyetjeve që parashtrihen. Për shembull, mund të synohet një grup njerëzish që së bashku përfaqësojnë popullsinë në tërësi, ose grupe me përvoja të veçanta jetësore;
- **I përshtatur me rrethanat** – metoda e përzgjedhur e angazhimit duhet të jetë e përshtatshme për njerëzit që dëshironi të përfshini, për temën që diskutohet dhe për pyetjet që ju parashtroni;
- **I përshtatshëm në kohë** – duhet të sigurohet kohë e mjaftueshme për pjesëmarrjen e njerëzve (p.sh. që ata të kenë mundësi të dëgjojnë për mundësinë për të marrë pjesë, të përthithin informacionin e nevojshëm dhe të japin mendimet e tyre);
- **I qasshëm** – elementë si informacioni i paraqitur, vendndodhjet, oraret, teknikat e lehtësimit të përdorura etj., duhet të jenë të aksesueshme për të gjithë ata që dëshironi të përfshihen;
- **Transparent** – ofron informacion të qartë dhe të aksesueshëm publikisht për aspekte të tilla si: kush e ka porositur dhe financuar këtë mundësi për angazhim, çfarë informacioni u jepet pjesëmarrësve (nëse u jepet), si raportohen mendimet e njerëzve dhe çfarë kanë thënë ata, si do të përdoren rezultatet në proceset e vendimmarrjes, dhe çfarë do të realizohet apo jo si rezultat i angazhimit;
- **I kompletuar** - është gjithashtu e rëndësishme të mbyllet rrethi i feedback-ut me ata që kanë marrë pjesë në proces, në mënyrë që ata të dinë se si mendimet e tyre kanë ndihmuar në informimin apo formësimin e punës së parlamentit.

5. SPEKTRI I PJESËMARRJES DHE KRIJIMI I MUNDËSIVE

Pjesëmarrja mund të marrë disa forma, ndër të cilat edhe pjesëmarrjen publike.

- **Pjesëmarrja sociale:** Këtu klasifikohen aktivitetet kolektive si vullnetarizmi, grupet komunitare, ndihma e ndërsjellë etj.
- **Pjesëmarrja individuale:** Zgjedhjet dhe veprimet personale që reflektojnë llojin e shoqërisë ku dikush dëshiron të jetojë, si p.sh. mënyra e shpenzimit të parave apo dhurimi për bamirësi.
- **Pjesëmarrja publike:** Angazhimi i individëve me institucionet demokratike dhe proceset vendimmarrëse, duke përfshirë votimin, kontaktimin e përfaqësuesve politikë, fushatat dhe lobimin, si dhe pjesëmarrjen në konsultime apo iniciativa të tjera të qeverisë apo institucioneve të tjera.
- **Pjesëmarrja komunitare:** Nuk kufizohet vetëm te interesat individuale. Grupet e organizuara të komunitetit shpesh shërbejnë si mekanizma pjesëmarrjeje, duke u fokusuar në çështje që prekin një zonë ose një komunitet më të gjerë.

Identifikimi i mundësive për pjesëmarrje kërkon njohuri mbi:

- Nivelet e ndryshme të pjesëmarrjes, të njohura si spektri i pjesëmarrjes
- Faza të ndryshme të hartimit dhe zbatimit të politikave, kur pjesëmarrja mund të aplikohet

Duke përdorur këtë informacion, mund të vendosni se cilat nivele të pjesëmarrjes janë më të përshtatshme, në varësi të fazës së hartimit të politikave ku ndodheni. Gjithashtu, mund të planifikoni përpara për të identifikuar mundësi të ardhshme ku nivele të ndryshme të pjesëmarrjes mund të jenë të mundshme dhe të dobishme.

Spektri i pjesëmarrjes publike i Shoqatës Ndërkombëtare për Pjesëmarrjen Publike (IAP2)³ është një mjet i dobishëm për planifikimin e pjesëmarrjes dhe ndihmon në përmbushjen e disa prej parimeve të angazhimit të përmendura më sipër. Ky spektër thekson nevojën që parlamentet dhe aktorët e tjerë të jenë të qartë me publikun për nivelin e ndikimit që u ofrohet në çdo proces angazhimi. Kjo është thelbësore për menaxhimin e pritshmërive të qytetarëve dhe për të siguruar që angazhimi të jetë transparent dhe domethënës për të gjithë të përfshirët. Gjithashtu u mundëson qytetarëve të marrin një vendim të informuar nëse do të marrin pjesë apo jo.

Spektri i pjesëmarrjes (paraqitur më poshtë) përfshin një gamë të gjerë aktiviteteve, nga informimi pasiv deri te delegimi aktiv i vendimmarrjes.

- **Informimi:** Ofrimi i informacionit për qytetarët.
- **Konsultimi:** Mbledhja e feedback-ut nga qytetarët.
- **Përfshirja:** Angazhimi i qytetarëve në diskutime dhe vendimmarrje.
- **Bashkëpunimi:** Punë e përbashkët midis institucioneve dhe qytetarëve.
- **Delegimi:** Dhënia e autoritetit vendimmarrës qytetarëve për çështje specifike.

3 Shiko https://cdn.ymaws.com/www.iap2.org/resource/resmgr/pillars/iap2_spectrum_2024.pdf

Spektri i pjesëmarrjes është një mënyrë për të klasifikuar nivelet e pjesëmarrjes sipas qëllimit të tyre dhe rolit që u ofrohet pjesëmarrësve. Ai është pranuar gjerësisht si një mjet për të kuptuar rolet e ndryshme që njerëzit mund të luajnë në një proces të nisur nga qeveria, parlamenti, etj.

Më poshtë detajohet një version i Spektrit të Pjesëmarrjes Publike, i cili nuk sugjeron ndonjë renditje për nga rëndësia e pjesëmarrjes, por thekson se nivele të ndryshme të pjesëmarrjes kanë funksione të ndryshme. Të gjitha janë të dobishme dhe të përshtatshme në pika të ndryshme të procesit të hartimit të politikave dhe vendimmarrjes. Mund të zgjidhni të përdorni më shumë se një nivel në fazë të ndryshme të një procesi.

Angazhimi në secilin nivel përfshin një ofertë të ndryshme për pjesëmarrësit në lidhje me mënyrën se si do të përdoret kontributi i tyre. Është e rëndësishme të jeni të qartë me pjesëmarrësit mbi nivelin e angazhimit që ofrohet dhe mbi mundësitë që do të kenë për të marrë pjesë. Kjo ndihmon në menaxhimin e pritshmërive dhe u lejon njerëzve të bëjnë një zgjedhje të informuar mbi mënyrën dhe kohën kur duan të angazhohen.

Tabela 5-1. Nivelet e pjesëmarrjes dhe angazhimit qytetar

Niveli	Qëllimi	Çfarë u premtohet pjesëmarrësve?
Informim	<ul style="list-style-type: none"> ■ Të ofrojë informacion të balancuar dhe objektiv për publikun ■ Të informojë grupet e interesuara mbi zhvillimet dhe rezultatet 	<ul style="list-style-type: none"> ■ Do t'ju mbajmë të informuar ■ Do të ofrojmë informacion në mënyrë të hapur dhe transparente ■ Nuk do të mbajmë të fshehur informacionin e rëndësishëm
Konsultim	<ul style="list-style-type: none"> ■ Të marrim reagime mbi analizat, alternativat, propozimet dhe vendimet ■ Të informojmë ata që marrin vendime ose zhvillojnë propozime 	<ul style="list-style-type: none"> ■ Do t'ju mbajmë të informuar ■ Do të dëgjojmë dhe marrim në konsideratë shqetësimet dhe aspiratat tuaja ■ Do të vlerësojmë seriozisht kontributin tuaj ■ Do të jemi të hapur ndaj ndikimit tuaj ■ Do të ofrojmë reagime mbi mënyrën se si kontributi juaj ka ndikuar në rezultatin përfundimtar
Përfshirje	<ul style="list-style-type: none"> ■ Të punojmë drejtpërdrejt me pjesëmarrësit gjatë gjithë procesit të hartimit të politikave ose vendimmarrjes ■ Të sigurojmë që shqetësimet dhe aspiratat e tyre të kuptohen dhe të merren në konsideratë ■ Të mundësojmë ndikim të drejtpërdrejtë mbi vendimet dhe opsionet e zhvilluara 	<ul style="list-style-type: none"> ■ Do t'ju mbajmë të informuar ■ Do të punojmë me ju për të siguruar që shqetësimet dhe aspiratat tuaja të reflektohen drejtpërdrejt në rezultatet ose alternativat e zhvilluara ■ Do të ofrojmë reagime mbi ndikimin e kontributit tuaj në vendimin përfundimtar

Niveli	Qëllimi	Çfarë u premtohet pjesëmarrësve?
Bashkëpunim	<ul style="list-style-type: none"> ■ Të krijojmë një partneritet me pjesëmarrësit në çdo aspekt të vendimmarrjes, përfshirë përcaktimin e çështjeve, zhvillimin e alternativave dhe identifikimin e zgjidhjeve të preferuara ■ Të ndajmë procesin e zhvillimit dhe vendimmarrjes sa më shumë të jetë e mundur 	<ul style="list-style-type: none"> ■ Do të kërkojmë këshilla dhe inovacione nga ju për të formuluar zgjidhje ■ Do të përfshijmë këshillat dhe rekomandimet tuaja në vendimet ose zbatimin e tyre sa më shumë të jetë e mundur
Delegim	<ul style="list-style-type: none"> ■ Të vendosim vendimmarrjen përfundimtare në duart e pjesëmarrësve ■ Të transferojmë aftësinë për të marrë vendime dhe/ose për të ndër marrë veprime 	<ul style="list-style-type: none"> ■ Do të zbatojmë atë që ju vendosni

6. CIKLI I PJESËMARRJES

Cikli për zbatimin e procesit që garanton pjesëmarrje përfshin disa faza, të cilat paraqiten me poshtë. Ekzistojnë mundësi për pjesëmarrje në secilën fazë të ciklit të politikëbërjes dhe vendimmarrjes. Nivele të ndryshme të përfshirjes sigurojnë lloje të ndryshme informacioni për vendimmarrësit në çdo fazë. Për të zgjedhur qasjen më të përshtatshme, është e rëndësishme të kuptohet qartë qëllimi i angazhimit dhe kontributi që pritet nga pjesëmarrësit.

Për të mbështetur këtë proces, mund të përdoren standardet kombëtare për angazhimin komunitar dhe platforma të dedikuara për planifikimin dhe vlerësimin e ndërveprimeve me publikun.

Tabela 6-1. Fazat kryesore të ciklit të politikave

1. Përcaktimi i vizionit – Kjo fazë synon identifikimin dhe kuptimin e çështjes që do të trajtohet, duke përcaktuar gjithashtu kufizimet dhe fushën e veprimit të politikës.
2. Zhvillimi – Faza ku eksplorohehen opsione dhe rekomandime të mundshme. Pjesëmarrja është më e vlefshme në këtë fazë, pasi përfshirja e vonshme mund të kufizojë alternativat.
3. Vlerësimi – Shqyrtimi dhe analizimi i opsioneve për të matur mbështetjen, identifikuar sfidat dhe bërë përmirësime. Kjo fazë përfundon me një propozim të qartë politikash.
4. Marrja e vendimit – Faza ku merret një vendim përfundimtar mbi një politikë apo strategji. Edhe pse mundësitë për pjesëmarrje direkte janë të kufizuara, po rritet tendenca për qasje bashkëpunuese në vendimmarrje.
5. Zbatimi – Vendosja në praktikë e shërbimeve, strategjive apo politikave të miratuara. Pjesëmarrja në këtë fazë ndodh kryesisht nëpërmjet partneriteteve për zbatim.
6. Vlerësimi përfundimtar – Analiza e dizajnit, zbatimit dhe rezultateve të politikës për të nxjerrë mësim, përmirësuar qasjet dhe shmangur përsëritjen e gabimeve.

7. MUNDËSITË PËR ANGAZHIM DHE PJESËMARRJE ME KUVENDIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

7.1 MUNDËSI PËR ANGAZHIM ME KUVENDIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Kuvendi i Shqipërisë ka ndërmarrë hapa për të rritur transparencën dhe për të inkurajuar pjesëmarrjen e qytetarëve. Disa nga mundësitë për angazhim përfshijnë:

- **Seancat e hapura:** Qytetarët mund të marrin pjesë si vëzhgues në seancat plenare dhe mbledhjet e komisioneve parlamentare.
- **Konsultimet publike:** Para miratimit të ligjeve të rëndësishme, Kuvendi organizon konsultime publike për të mbledhur opinione dhe sugjerime nga qytetarët dhe grupet e interesit.
- **Platforma online:** Përdorimi i platformave digjitale për të lehtësuar komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit me publikun.

Kuvendit⁴ publikon raporte vjetore mbi angazhimin e publikut dhe shoqërisë civile në proceset e tij vendimmarrëse. Raporti më i fundit mbi aktivitetin përgjatë viti 2023, analizon angazhimin e qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile në veprimtarinë parlamentare, përfshirë punën e komisioneve dhe nënkomisioneve (duke evidentuar numrin e mbledhjeve, dëgjësave dhe ndryshimeve të propozuara nga deputetët dhe shoqëria civile). Ai gjithashtu shqyrton mekanizmat e koordinimit me shoqërinë civile, si regjistrat elektronikë dhe platforma për konsultim publik. Në përfundim, identifikohen sfidat për të ardhmen dhe rekomandimet për përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet Kuvendit dhe shoqërisë civile e publikut, për të cilat, ndihmon edhe ky dokument orientues.

Gjatë viteve të fundit, Parlamenti, me mbështetjen e partnerëve, ka testuar edhe praktika të tjera të mira në këtë fushë. Një shembull i veçantë është përdorimi i "Paneleve të Qytetarëve" (i përshkruar më poshtë), i cili u zbatua për herë të parë në Shqipëri në tetor të vitit 2024.

7.2 ZHVILLIMI I PRAKTIKAVE GJITHËPËRFSHIRËSE TË ANGAZHIMIT TË QYTETARËVE

Një pjesë e mirë e vlerës së angazhimit publik në proceset vendimmarrëse të parlamenteve qëndron në krijimin e mundësive që deputetët të dëgjojnë nga qytetarët (përfshirë ata nga të cilët nuk do të kishin pasur mundësi që të dëgjonin zakonisht), në momente dhe forma që nuk janë të zakonshme për komunikimin me ta. Por kjo është e mundur vetëm nëse angazhimi është i aksesueshëm dhe gjithëpërfshirës për një gamë të gjerë njerëzish.

Aksesueshmëria dhe përfshirja janë gjithashtu thelbësore për përmbushjen e angazhimit të Kushtetutës së Shqipërisë për të garantuar mundësi të barabarta për pjesëmarrje në proceset vendimmarrëse.

4 Shiko këtu: <https://www.parlament.al/struktura/1f6ca8d8-fdf4-440b-869d-05ac3d0b915d>

Çështjet që duhen marrë parasysh për të siguruar aksesueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen janë:

- **Logjistika** – p.sh. në cilën ditë të javës dhe në çfarë ore zhvillohet event, nëse pjesëmarrësit e kanë të mundur të arrijnë në vendin e zhvillimit të aktivitetit (nëse ka një të tillë) dhe nëse ai është i aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara, nëse mund të përmbushen nevoja të veçanta për ushqim apo akses, zgjedhja e mënyrave të komunikimit, e kështu me radhë;
- **Mbështetja** – nënkupton çdo mbështetje shtesë që pjesëmarrësve potencialë mund t'u nevojitet për t'u ndier të sigurt dhe rehat për të marrë pjesë;
- **Përballueshmëria** – në parim, asnjë pjesëmarrës nuk duhet të përfundojë duke shpenzuar nga xhepi i vet për të marrë pjesë/angazhuar, por duhet të sigurohet mbulim i shpenzimeve (p.sh. udhëtimi, kujdesi për fëmijët) në mënyrë që njerëzit të kenë mundësi reale për të marrë pjesë. Kur angazhimi zgjat për një kohë të konsiderueshme (p.sh. mbi 30 minuta), është e zakonshme të ofrohet një shpërblim financiar ose një dhuratë simbolike në shenjë falënderimi për kohën e pjesëmarrësve. Kjo vlerëson kohën dhe përpjekjen e tyre, dhe është thelbësore për disa njerëz që të mund të marrin pjesë;
- **Përmbajtja** – d.m.th. ofrimi i një përmbajtje pa zhargon teknik, në sasi të përballueshme dhe në formate të përshtatshme, që niset nga njohuritë dhe përvoja aktuale e pjesëmarrësve dhe jo nga supozimi i një njohurie të mëparshme, duke iu përshtatur stileve të ndryshme të të nxënit;
- **Formulimi i çështjeve** – pra, paraqitja e pyetjeve për pjesëmarrësit në një mënyrë që lidhet me jetën dhe perspektivat e tyre, dhe jo në terma të politikave publike;
- **Dizajni i angazhimit** – p.sh. të mendohet me kujdes dhe në mënyrë të qëllimshme se kë dëshironi të përfshini dhe të merren parasysh nëndarjet dhe ndërthurjet brenda atyre grupeve (p.sh. dallimet e mundshme sipas gjeografisë, moshës, gjinisë, etnisë, aftësisë së kufizuar, të ardhurave, etj.); zgjedhja e një metode angazhimi që është e përshtatshme për pjesëmarrësit e synuar dhe temën që diskutohet.

Zyrtarët parlamentarë mund të zgjedhin të identifikojnë dhe të adresojnë vetë çështjet e mësipërme. Përndryshe, ata mund të kërkojnë të bashkëpunojnë me organizatat e shoqërisë civile. Për shembull, Parlamenti i Skocisë bashkëpunoi me grupe të shoqërisë civile në secilën prej tetë rajoneve parlamentare të Skocisë për të projektuar dhe zhvilluar aktivitete angazhimi qytetar në kuadër të përvjetorit të 25-të të tij.⁵

Zhvillimi i angazhimit gjithëpërfshirës dhe të aksesueshëm: dy raste studimore

1. Projektligji për Gjuhën e Shenjave Britanike (Uells), Senedd Cymru, 2025

Kur Mark Isherwood MS propozoi Projektligjin për Gjuhën e Shenjave Britanike (BSL) në Uells, Ekipi për Angazhimin e Qytetarëve krijoi një program për të mbledhur përvojat e jetuara të përdoruesve të BSL dhe familjarëve të tyre.

Për të siguruar aksesueshmëri, ekipi bashkëpunoi ngushtë me përdorues të BSL për të hartuar procesin e angazhimit. Kontributi i tyre përcaktoi mënyrën se si pjesëmarrësit do të merrnin pjesë, duke siguruar që metodat e komunikimit dhe ambientet të përmbushnin nevojat e tyre. U përdor një qasje cilësore, përmes fokus-grupeve dhe intervistave, që u mundësuan pjesëmarrësve të ndanin pikëpamjet e tyre në mënyrë fleksibile.

5 Më shumë këtu: <https://www.parliament.scot/get-involved/25th-anniversary>

77 persona morën pjesë në program, nga tre deri në 84 vjeç. Pjesëmarrësit përfshinin persona që nuk dëgjonin e që përdornin BSL, prindër dhe anëtarë të familjes, të moshuar, persona me aftësi të kufizuara fizike dhe individë nga pakicat etnike. Për të eliminuar pengesat, u siguruan përkthyes të kualifikuar të BSL dhe pjesëmarrja ishte e mundur fizikisht, online ose përmes email-it.

Gjetjet nga ky angazhim po përkthehen aktualisht në BSL, duke siguruar aksesueshmëri në çdo fazë. Nëpërmjet bashkëpunimit me komunitetin e personave që nuk dëgjojnë dhe integritit të praktikave gjithëpërfshirëse, zëri i përdoruesve të BSL do të jetë në qendër të zhvillimit të këtij projektligji.

2. Komiteti për Shëndetësinë dhe Kujdesin Social, Senedd Cymru, 2022 – Hetimi mbi pabarazitë në shëndetin mendor

Komiteti për Shëndetësinë dhe Kujdesin Social synoi të eksploronte pengesat për të marrë kujdes për shëndetin mendor dhe të kuptonte pse disa grupe përballen me pabarazi më të mëdha se të tjerët. Për të mbështetur këtë hetim, Ekipi për Angazhimin e Qytetarëve në Senedd lehtësoi një grup këshillimor online të përbërë nga individë me përvoja të drejtpërdrejta me pabarazitë në shëndetin mendor.

Pjesëmarrësit përfaqësuan një gamë të gjerë prej mbi 18 diagnozash të ndryshme, përfshirë ADHD, autizëm, paralizë cerebrale, disleksi, depresion pas lindjes dhe psikoze.

Për të garantuar akses dhe pjesëmarrje kuptimplotë, u zbatua një program i plotë mbështetës. Para fillimit të takimeve të grupit këshillimor, secili pjesëmarrës mori pjesë në një seancë individuale për të diskutuar nevojat e tij/saj për akses. Pjesëmarrësit gjithashtu u ftuan në një "Workshop Mirëseardhjeje", i cili synonte të prezantonte procesin këshillimor, të adresonte shqetësimet dhe të krijonte një ndjenjë komuniteti. Çdo individ iu caktua një kontakt i dedikuar në Senedd, që ofronte udhëzime dhe mbështetje të vazhdueshme gjatë gjithë procesit.

U ofrua një gamë burimesh për të përmirësuar aksesueshmërinë dhe lehtësinë e pjesëmarrjes. Këto përfshinin: pyetje të shpeshta (FAQ), video shpjeguese dhe një fletë informative të detajuar për shërbimet e disponueshme të shëndetit mendor. Të gjitha materialet ishin të shkruara në një gjuhë të thjeshtë, me veprime të qarta në formë pikash. Për të ndihmuar individët me disleksi, dokumentet dhe email-et u përgatitën me sfond blu të çelët për të reduktuar stresin vizual.

Duke njohur se pjesëmarrësit kishin preferenca dhe nevoja të ndryshme, materialet u shpërndanë në formatin Word për t'u përshtatur sipas dëshirës. Një udhëzues u ofrua për të shpjeguar si mund t'i përshtatnin dokumentet sipas nevojave të tyre, përfshirë funksione si "Lexim me Zë", ndryshimi i ngjyrës së sfondit, madhësia dhe ngjyra e tekstit. Njohuri shtesë nga organizatat e sektorit të tretë të specializuara në diagnoza të ndryshme ndihmuan gjithashtu në përcaktimin e masave për aksesueshmëri.

Për ata që morën pjesë në një debat në Senedd, u morën masa të veçanta për të krijuar një ambient më të rehatshëm. Ekipet e sigurisë organizuan një hyrje të qetë me ndriçim të zbutur, dhe u krijua një hapësirë e qetë ku pjesëmarrësit mund të pushonin nëse kishin nevojë.

Një pjesëmarrës u shpreh:

"Që në fillim, ndjeva se po më dëgjonin. Ata morën kohën që të gjenin mënyrën më të mirë që unë të mund të përfshihesha. Unë preferoj mesazhet me video në vend të email-it, dhe ata ashtu bënë."

Anëtarët e grupit këshillimor luajtën një rol kyç në formësimin e punës së komitetit. Pikëpamjet e tyre ndikuan në rekomandimet e komitetit dhe në përgjigjen e Qeverisë së Uellsit. Gjatë debatit plenar, kontributet e tyre u cituan drejtpërdrejt, duke theksuar rëndësinë e përvojave të jetuara në hartimin e politikave. Më pas, ministri përkatës i Qeverisë së Uellsit u takua privatisht me grupin, duke u dhënë atyre mundësinë të kontribuonin drejtpërdrejt në përmirësimin e politikave për shëndetin mendor.

8. PRAKTIKA TË MIRA

Në vitet e fundit, përveç konsolidimit të praktikave për pjesëmarrjen e publikut dhe shoqërisë civile në veprimtarinë parlamentare, si veprimtaritë e komisioneve dhe nënkomisioneve parlamentare apo përfundimit të mekanizmit për koordinimit me shoqërinë civile, përfshirë regjistrat elektronikë dhe platformën e konsultimit publik, Kuvendi, me mbështetjen e partnerëve, ka testua edhe praktika të tjera të mira në këtë drejtim.

Një praktikë e mirë dhe mënyrë e re për kontekstin tonë për përfshirjen e qytetarëve në proceset parlamentare janë "Panelet Qytetare". Më poshtë paraqitet një informacion i përmbledhur lidhur me këtë praktikë të re, të aplikuar për herë të parë në Shqipëri në tetor të vitit 2024.⁶

Panelet Qytetare

Më datat 17-19 tetor 2024, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), së bashku me ekspertë të Involve UK, zbatoi metodologjinë deliberative të Paneleve Qytetare për dy tema: a. zhvillimin e turizmit rural dhe malor, dhe b. çështjet e aftësisë së kufizuar.⁷

Qëllimi i pilotimit të Paneleve Qytetare me Kuvendin e Shqipërisë ishte krijimi i një hapësire për diskutimin në mënyrë të informuar të disa çështjeve në fokus të veprimtarisë së Komisioneve Parlamentare, si dhe kontribuimi në forcimin e transparencës dhe përfshirjes së qytetarëve në aktivitetin legjislativ dhe mbikëqyrës të parlamentit.

Panelet Qytetare, një metodologji e demokracisë deliberative e përdorur në Mbretërinë e Bashkuar dhe vende të tjera të Evropës, madje edhe nga Parlamenti Evropian, përfshiu mbi 80 qytetarë të përzgjedhur rastësisht nga i gjithë vendi. Ata u informuan nga më shumë se 20 ekspertë dhe politikëbërës të fushave përkatëse.

Ky aktivitet u dha mundësinë qytetarëve pjesëmarrës të angazhoheshin në një proces të thelluar dhe informuar konsultimi. Në përfundim, Panelet Qytetare dolën me një listë me nga 10 rekomandime me masa konkrete me qëllim bashkë-formimin e politikave të turizmit malor dhe ato të aftësisë së kufizuar.⁸

Në vazhdim, më 11 dhjetor 2024, IDM ka zhvilluar një dëgjese publike⁹ për rekomandimet për turizmin rural dhe malor me anëtarë të Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, si dhe përfaqësues të ekzekutivit, qeverisjes vendore dhe një përfaqësie të qytetarëve pjesëmarrës në Panelet Qytetare. Qëllimi i dëgjesës ishte informimi i deputeteve për rekomandimet e "Paneleve Qytetare" mbi turizmin malor dhe integrimi i perspektivës qytetare mbi prioritetet dhe masat konkrete për zhvillimin e turizmit malor në nismën e qeverisë "Paketa e Maleve".

Rekomandimet e Paneleve Qytetare dhe analiza e eksperteve të fushës për ndryshime ligjore dhe institucionale është ndarë me anëtarët e Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Një proces i ngjashëm u zhvillua edhe me dëgjese për çështjet prioritare për personat me aftësi të kufizuar me anëtarët e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.¹⁰

6 Në kuadër të projektit "Rritja e përgjegjshmërisë së parlamentit ndaj shqetësimeve të qytetarëve" zbatuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), Instituti Shqiptar i Shkencës dhe Citizens Channel, me mbështetjen financiare të Qeverisë Britanike.

7 <https://idmalbania.org/sq/news-cpt/panelet-qytetare-nje-menyre-e-re-per-te-perfshire-qytetaret-ne-proceset-parlamentare/>

8 Në vijim gjenden dy video përmbledhëse të Paneleve Qytetare: <https://youtu.be/6plwb6F0uBw> dhe https://youtu.be/lbw4loQQ_pl.

9 <https://idmalbania.org/sq/news-cpt/degjese-publike-mbi-rekomandimet-e-paneleve-qytetare-per-turizmin-rural-dhe-malor-dhe-paketen-e-maleve/>

10 <https://idmalbania.org/sq/event-cpt/degjese-publike-mbi-rekomandimet-e-paneleve-qytetare-per-ceshtjet-e-afetise-se-kufizuar/>

Praktika të tjera që inkurajohen dhe janë të mundura që të zbatohen janë:

1. Asamblëtë Qytetare

Asamblëtë Qytetare janë një formë e aktiviteteve deliberative që përfshin një grup relativisht të madh (50-250) personash, të përzgjedhur për të qenë përfaqësues të demografisë të popullsisë së përgjithshme, të cilët mblidhen për të diskutuar mbi një çështje. Një Asamble Qytetare zakonisht zhvillohet për disa ditë, shpesh të shpërndara në javë ose muaj.

Përdoret kryesisht në fazat e përcaktimit të vizionit, zhvillimit dhe/ose vlerësimit të ciklit të hartimit të politikave, por mund të shërbejë edhe si një mjet delegimi në fazën e vendimmarrjes.

Rezultatet që synohen përmes kësaj praktike janë:

- Gjenerimi i ideve të reja
- Përmbledhja e perspektivave/shqetësimeve
- Zhvillimi i rekomandimeve për zbatim
- Vendosja e prioriteteve për përmirësim
- Vlerësim i propozimeve

Pjesëmarrësit tipikë:

- Një kampion përfaqësues (i njohur si “mini-publik”)

2. Juritë Qytetare

Juritë Qytetare janë një formë tjetër deliberative ku përfshihet një grup i vogël qytetarësh (12-24) personash, të përzgjedhur për të përfaqësuar demografikisht një popullsi të caktuar, të cilët mblidhen për të diskutuar një çështje për një periudhë prej 2-7 ditësh (jo domosdoshmërisht të njëpasnjëshme).

Përdoret kryesisht në fazat e zhvillimit dhe/ose vlerësimit të ciklit të politikave. Më rrallë, mund të përdoret si një mjet delegimi në fazën e vendimmarrjes.

Rezultatet që synohen:

- Marrja e një vendimi specifik (p.sh. një verdikt)
- Zhvillimi i rekomandimeve për zbatim
- Vendosja e prioriteteve për përmirësim
- Vlerësim i propozimeve

Pjesëmarrësit tipikë:

- Një kampion përfaqësues (i njohur si “mini-publik”)

3. Kërkimi Qytetar

Kërkimi qytetar identifikon ata që preken më shumë nga një vendim ose politikë, i trajnon dhe i mbështet për të udhëhequr angazhimin më të gjerë me bashkëmoshatarët e tyre dhe sjell prova nga ky angazhim tek qeveria.

Përdoret kryesisht për përfshirje dhe bashkëpunim, veçanërisht në fazat e përcaktimit të vizionit dhe vlerësimit të ciklit të politikave.

Rezultatet që synohen:

- Identifikimi i çështjeve
- Ide të reja
- Kuptim më i mirë i nevojave të përdoruesve të shërbimeve
- Përmbledhje e perspektivave/shqetësimeve
- Prioritete për përmirësim

Pjesëmarrësit tipikë:

- Përdoruesit ekzistues të një shërbimi / ata me përvojë të drejtpërdrejtë mbi temën
- Persona me interes të veçantë për çështjen
- Ata që ka gjasa të preken më shumë (tani ose në të ardhmen)

4. Kërkimi për Veprim i Udhëhequr nga Komuniteti

Duke ndjekur një qasje të ngjashme me kërkimin qytetar, kërkimi i veprimit i udhëhequr nga komuniteti është një proces ku vetë komuniteti vendos mbi çështjen që do të hulumtohet, harton dhe zhvillon kërkimin, dhe përdor rezultatet për të sjellë ndryshime pozitive. Ndiham mund të kërkohet nga akademikë, zyrtarë lokalë ose organizata me ekspertizë kërkimore, por në fund të fundit, është komuniteti ai që vendos se çfarë dëshiron të zbulojë, si do ta bëjë këtë dhe përse.

Përdoret kryesisht për përfshirje dhe bashkëpunim, veçanërisht në fazat e përcaktimit të vizionit dhe vlerësimit të ciklit të politikave. Fokusimi në veprim për të prodhuar ndryshime e bën atë të përshtatshëm për çdo fazë të ciklit të politikave.

Rezultatet që synohen:

- Identifikimi i çështjeve
- Ide të reja
- Kuptim më i mirë i nevojave të përdoruesve të shërbimeve
- Përmbledhje e perspektivave/shqetësimeve
- Prioritete për përmirësim

Pjesëmarrësit tipikë:

- Përdoruesit ekzistues të një shërbimi / ata me përvojë të drejtpërdrejtë mbi temën
- Persona me interes të veçantë për çështjen
- Ata që ka gjasa të preken më shumë (tani ose në të ardhmen)

5. Workshope Deliberative

Një formë diskutimi të strukturuar në grup, e cila u ofron pjesëmarrësve mundësinë për të mësuar mbi një çështje, për ta shqyrtuar në mënyrë të thelluar, për të kuptuar dhe sfiduar mendimet e njëri-tjetrit, përpara se të arrijnë në një përfundim të informuar.

E përshtatshme për konsultim, përfshirje dhe bashkëpunim, dhe mund të përdoret në të gjitha fazat e ciklit të politikave.

Rezultatet që synohen:

- Identifikimi i çështjeve
- Ide të reja
- Kuptim më i mirë i nevojave të përdoruesve të shërbimeve
- Vlerësim i mënyrës së ofrimit të shërbimeve / situatës aktuale
- Përmbledhje e perspektivave/shqetësimeve
- Rekomandime për zbatimin e politikave
- Prioritete për përmirësim
- Vlerësim i propozimeve – preferencat dhe pranueshmëria e tyre

Pjesëmarrësit tipikë:

- Çdo grup pjesëmarrësish, veçanërisht ata me pikëpamje fillimisht të kundërta

6. Dialogje të Shpërndara

Evente të decentralizuara të bazuara në biseda, ku palët e interesuara dhe pjesëmarrës të tjerë organizojnë grupe dhe aktivitete për të diskutuar mbi një temë të dakordësuar me organin përgjegjës, duke ndjekur një format të përcaktuar dhe materiale mbështetëse.

Më e përshtatshme për konsultim, veçanërisht në fazat e përcaktimit të vizionit, zhvillimit, vlerësimit dhe monitorimit të ciklit të politikave.

Rezultatet që synohen:

- Identifikimi i çështjeve
- Ide të reja
- Përmbledhje e perspektivave/shqetësimeve

Pjesëmarrësit tipikë:

- Përdoruesit ekzistues të një shërbimi / ata me përvojë të drejtpërdrejtë mbi temën
- Persona me interes të veçantë për çështjen
- Ata që ka gjasa të preken më shumë (tani ose në të ardhmen)

7. “Hapësira e Hapur”

E njohur ndryshe si “Hapësira e Hapur e Teknologjisë”, kjo është një mënyrë për t'u mundësuar pjesëmarrësve të diskutojnë çështjet që i konsiderojnë më të rëndësishme brenda një teme më të gjerë. Këto evente udhëhiqen nga një lehtësues. Lehtësuesi prezanton temën dhe më pas u kërkon pjesëmarrësve të propozojnë çështjet kryesore për diskutim. Pjesëmarrësit që kanë një ide për një temë dalin përpara dhe shumë shkurtimisht paraqesin për pjesën tjetër të grupit se çfarë do të donin të diskutonin. Lehtësuesi përmbledh idenë e tyre në një kartë dhe e ekspozon për t'u parë nga të gjithë pjesëmarrësit. Pasi të jenë mbledhur të gjitha idetë, lehtësuesi pyet pjesëmarrësit nëse ndonjë prej temave është shumë e ngjashme dhe duhet bashkuar. Pasi kjo të zgjidhet, çdo temë e mbetur caktohet në një vendndodhje dhe një orar për diskutim. Në varësi të kohëzgjatjes së ngjarjes dhe numrit të temave të propozuara, mund të ketë vetëm një raund diskutimesh, ose dy, ose më shumë. Zakonisht përfundojnë me bashkimin e të gjithë pjesëmarrësve për të dëgjuar ose për të lexuar (nga fletët e komenteve) se çfarë përfundimesh nxori secili grup diskutimi.

Rezultatet që synohen:

- Identifikimi i temave përkatëse nga vetë pjesëmarrësit;
- Ngritja e çështjeve që mund të mos jenë pjesë e diskursit institucional;
- Gjenerimi i ideve të freskëta dhe zëra të ndryshëm mbi një temë të caktuar;
- Nxitja e dialogut të lirë dhe krijimi i një mjedisi pjesëmarrës dhe gjithëpërfshirës.

Pjesëmarrësit tipikë:

- Qytetarë të interesuar;
- Anëtarë të komuniteteve të prekura nga një temë e caktuar;
- Profesionistë të një fushe specifike;
- Përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile;
- Persona me përvoja të ndryshme jetësore që kanë diçka për të ndarë në lidhje me temën.

8. Ngjarjet Piramidë

Ngjarjet në formë Piramide i referohen një strukture ngjarjesh/aktivitetesh dhe jo një metode të veçantë të përfshirjes.

Kjo përfshin një proces me dy faza, ku një sërë takimesh fillestare zhvillohen ose në vende të ndryshme gjeografike, ose me grupe të ndryshme pjesëmarrësish (p.sh. përdorues shërbimesh, profesionistë me specializime të ndryshme). Deputetët mund të marrin pjesë në këto evente nëse dëshirojnë, ose ato mund të drejtohen nga përfaqësues zyrtarë të Kuvendit.

Pas përfshirjes fillestare, organizohet një ngjarje përmbyllëse – zakonisht në Kuvend. Kjo sjell së bashku disa nga pjesëmarrësit e takimeve të para me deputetët përkatës. Hartimi i kësaj ngjarjeje përmbyllëse bazohet në gjetjet e fazës së parë. Ajo u jep deputetëve mundësinë të pyesin qytetarët rreth gjetjeve që kanë rezultuar nga faza e parë dhe të eksplorojnë më në detaje pikëpamjet dhe arsyet që qëndrojnë pas tyre. Gjithashtu, u jep mundësinë pjesëmarrësve nga takimet fillestare që t'u shpjegojnë drejtpërdrejt deputetëve mendimet dhe përvojat e njerëzve që morën pjesë bashkë me ta. Ata informohen paraprakisht se roli i tyre është të flasin në emër të të gjithë pjesëmarrësve të takimit të tyre fillestar, dhe jo vetëm për veten e tyre.

Më e përshtatshme për të dëgjuar interesin e publikut, mbulim të gjerë gjeografik dhe angazhim të drejtpërdrejtë.

Rezultatet që synohen:

- Mbledhja e mendimeve të një game të gjerë pjesëmarrësish në fazën e parë;
- Krijimi i një hapësire për ndërveprim të drejtpërdrejtë mes qytetarëve dhe deputetëve;
- Thellimi i kuptimit të gjetjeve përmes diskutimeve të drejtpërdrejta;
- Forcimi i lidhjes mes përfshirjes qytetare dhe vendimmarrjes parlamentare.

Pjesëmarrësit tipikë:

- Qytetarë dhe grupe të interesuara nga komunitete të ndryshme gjeografike;
- Përdorues të shërbimeve dhe qytetarë me përvoja të ndryshme jetësore;
- Profesionistë nga fusha të ndryshme (shëndetësi, arsim, etj.);
- Deputetë dhe përfaqësues institucionalë;
- Lehtësues dhe organizatorë të përfshirjes publike.

9. Fokus-grupet

Një diskutim i udhëhequr me një grup të vogël (6-15) personash. Zakonisht janë sesione të vetme (1-2 orë), megjithatë mund të organizohen disa në vende të ndryshme ose me grupe të ndryshme mbi të njëjtën temë.

Më efektive për konsultim, kryesisht në fazat e përcaktimit të vizionit dhe vlerësimit të ciklit të politikave.

Rezultatet që synohen:

- Identifikimi i çështjeve
- Kuptim më i mirë i nevojave të përdoruesve të shërbimeve
- Vlerësim i mënyrës së ofrimit të shërbimeve / situatës aktuale
- Përmbledhje e perspektivave/shqetësimeve
- Rekomandime për zbatimin e politikave

- Prioritete për përmirësim
- Vlerësim i propozimeve – preferencat dhe pranueshmëria e tyre

Pjesëmarrësit tipikë:

- Përdoruesit ekzistues të një shërbimi / ata me përvojë të drejtpërdrejtë mbi temën
- Kampion përfaqësues (i ashtuquajtur "mini-publik")
- Ata që ka gjasa të preken më shumë (tani ose në të ardhmen)

10. Intervistat

Intervistat gjysmë të strukturuar janë zakonisht biseda një-më-një midis një intervistuesi (p.sh. një zyrtar parlamentar) dhe personit pjesëmarrës. Ato realizohen duke siguruar konfidencialitet dhe, për rrjedhojë, liri për të intervistuarit që të shprehin mendimet e tyre. Megjithatë, kur njerëzit mund të ndihen të pasigurt apo të shqetësuar gjatë intervistimit, mund të jetë e dobishme të intervistohen dy ose më shumë persona së bashku (p.sh. dy të rinj që janë miq), për t'u dhënë atyre më shumë besim për të shprehur qëndrimet e tyre.

Vetë intervistat mund të përbëhen nga rreth pesë deri në dhjetë pyetje të hapura. Pyetja e parë në çdo intervistë duhet të jetë shumë e gjerë, duke u dhënë pjesëmarrësve mundësinë të flasin lirshëm rreth temës. Më pas, pyetjet mund të bëhen gradualisht më të specifikuar. Është e rëndësishme që pyetjet të mos jenë udhëzuese për përgjigjet e mundshme.

Ka mënyra të ndryshme për t'i kthyer rezultatet e intervistave tek deputetët:

- Raporte të shkruara që përmbledhin temat kyçe që kanë dalë nga intervistat;
- Video e shkurtër me pjesë të përzgjedhura nga intervistat sipas temave, që përcjell pikat kryesore të diskutimeve. Intervistat mund të transkribohen që deputetët të kenë akses në versionin e plotë me shkrim;
- Albume fotografike me citime të përzgjedhura nga intervistat, të shoqëruara me fotografi të intervistuarve.

Të gjitha këto ndihmojnë deputetët të ndiejnë më drejtpërdrejt realitetin e jetës dhe përvojave të intervistuarve.

Rezultatet që synohen:

- Të kuptohet më në thellësi përvoja dhe këndvështrimi i individëve në lidhje me një çështje specifike;
- Të nxiten rrëfime personale që nuk mund të dalin lehtësisht në format më formale të konsultimit;
- Të përdoren format kreative për të transmetuar ndjeshmërinë dhe përvojën e jetuar te vendimmarrësit.

Pjesëmarrësit tipikë:

- Individë me përvojë të drejtpërdrejta mbi një temë të caktuar (p.sh. përdorues të shërbimeve, qytetarë të marginalizuar, profesionistë me përvojë të specializuar);

- Zyrtarë të Kuvendit që realizojnë intervistat;
- Në disa raste, deputetë që marrin pjesë në fazën përfundimtare për të dëgjuar rezultatet.

11. Vizitat

Vizitat kanë të bëjnë me shkuarjen e deputetëve dhe zyrtarëve atje ku ndodhen tashmë pjesëmarrësit, për t'u angazhuar me ta. Kjo eliminon nevojën që njerëzit të "vijjnë te" Kuvendi ose në një aktivitet që nuk kishin planifikuar ta ndiqnin, duke e bërë më të lehtë për ta përfshirjen. Gjithashtu, kjo lejon që angazhimi të ndodhë në një mjedis ku pjesëmarrësit ndihen rehat dhe, potencialisht, të mbështeten apo lehtësohen nga dikush që tashmë e njohin dhe i besojnë.

Angazhimi në këto evente zakonisht është informal ose gjysmë-formal, për shembull deputetët flasin me pjesëmarrësit të ulur në rreth, ose bisedojnë gjatë kohës së pushimeve me ndonjë pije apo ushqim. Deputetët dhe zyrtarët mund të kenë rënë dakord paraprakisht për disa pyetje që duan të shtrojnë – ndoshta në bashkëpunim me grupin që do të vizitojnë – si dhe të lënë hapësirë që biseda të rrjedhë natyrshëm.

Rezultatet që synohen:

- Të lehtësohet pjesëmarrja duke shkuar tek komunitetet në vend që të pritët që ato të vijjnë në institucione;
- Të krijohet një atmosferë më e rehatshme për bashkëbisedim dhe ndarje përvojash;
- Të dëgjohen drejtpërdrejt shqetësimet dhe nevojat e grupeve të ndryshme në vendin e tyre;
- Të ndërtohet besimi dhe ndërlidhja mes deputetëve dhe qytetarëve.

Pjesëmarrësit tipikë:

- Qytetarë nga komunitete të ndryshme, shpesh ata që zakonisht nuk përfshihen në konsultime formale;
- Grupi i personave që ndodhen në një mjedis të zakonshëm për ta (shkolla, qendër komunitare, institucion social, etj.);
- Deputetë dhe zyrtarë të administratës parlamentare;
- Lehtësues lokalë ose përfaqësues të komunitetit.

12. Grupet Drejtuese me Shumë Palë të Interesit

Këto përbëhen nga palë të interesuara (përfaqësues profesionalë, publikë dhe/ose të komunitetit) të cilët takohen në faza kyçe gjatë zhvillimit të një projekti për ta mbikëqyrur dhe për të ndikuar në vendimmarrjen strategjike.

Më të përshtatshme për përfshirje dhe bashkëpunim, dhe mund të përdoren në të gjitha fazat e ciklit të politikave.

Rezultatet që synohen:

- Ide të reja

- Rekomandime për zbatimin e politikave
- Prioritete për përmirësim
- Vlerësim i propozimeve – preferencat dhe pranueshmëria e tyre

Pjesëmarrësit tipikë:

- Persona me njohuri teknike / specialistë
- Palë të interesuara profesionale / publike
- Përdoruesit ekzistues të një shërbimi / ata me përvojë të drejtpërdrejtë mbi temën
- Ata që ka gjasa të preken më shumë (tani ose në të ardhmen)

13. “Crowdsourcing” në internet

“Crowdsourcing” shfrytëzon zgjidhjen bashkëpunuese të problemeve dhe inovacionin përmes një thirrjeje të hapur për ndihmë dhe ide, duke i lejuar çdo përdoruesi të internetit të kontribuojë përmes një platforme online, zakonisht sipas udhëzimeve të përgjithshme.

Më i përshtatshëm për konsultim dhe bashkëpunim, sidomos në fazën e vizionimit dhe zhvillimit të ciklit të politikave.

Rezultatet që synohen:

- Ide të reja
- Identifikimi i çështjeve

Pjesëmarrësit tipikë:

- Persona me njohuri teknike / specialistë
- Përdoruesit ekzistues të një shërbimi / ata me përvojë të drejtpërdrejtë mbi temën
- Persona të interesuar mbi çështjen

14. Sondazhet e opinionit

Mbledhja e të dhënave cilësore ose sasiore për të kuptuar dhe matur opinionin publik, duke anketuar një kampion përfaqësues të popullsisë.

Më të dobishme për konsultim, sidomos në fazat e vizionimit dhe vlerësimit të ciklit të politikave.

Rezultatet që synohen:

- Identifikimi i çështjeve
- Vendime specifike

- Përmbledhje e perspektivave/shqetësimeve
- Prioritete për përmirësim
- Rekomandime për zbatimin e politikave
- Vlerësim i propozimeve – preferencat dhe pranueshmëria e tyre

Pjesëmarrësit tipikë:

- Kampion përfaqësues i popullsisë ("mini-publik")

Parimet dhe strategjitë që mundësojnë aplikimin me sukses të këtyre praktikave të mira dokumentohen në këtë udhëzues.

9. ZHVILLIMI I STRATEGJIVE DHE PRAKTIKAVE EFEKTIVE DHE GJITHËPËRFSHIRËSE PËR ANGAZHIM DHE PJESËMARRJEN

Për të siguruar një angazhim efektiv dhe gjithëpërfshirës, Kuvendi mund të zbatojë strategji si:

- **Diversifikimi i kanaleve të komunikimit** për të arritur grupe të ndryshme të popullsisë.

Përdorimi i një game të gjerë kanalesh komunikimi është thelbësor për të arritur një audiencë sa më të gjerë. Kjo përfshin përdorimin e mediave tradicionale, platformave digjitale, si dhe kanaleve të tjera të komunikimit që janë të përshtatshme për grupe të ndryshme demografike. Për shembull, përdorimi i rrjeteve sociale mund të jetë efektiv për të angazhuar të rinjtë, ndërsa formatet e printuara mund të jenë më të përshtatshme për grupmoshat më të vjetra.

- **Zhvillimi i platformave digjitale** për lehtësimin e ndërveprimit me qytetarët.

Integrimi i teknologjive digjitale në proceset e angazhimit publik mund të lehtësojë ndërveprimin dhe të rrisë pjesëmarrjen. Krijimi i platformave online ku qytetarët mund të japin mendimet e tyre, të propozojnë ide dhe të marrin pjesë në diskutime është një mënyrë efektive për të përfshirë një audiencë më të gjerë. Këto platforma duhet të jenë të lehta për t'u përdorur dhe të aksesueshme për të gjithë.

- **Krijimi i mekanizmave të konsultimit të rregullt** me qytetarët, si forumet e hapura dhe panelet qytetare.

Organizimi i forumeve të hapura dhe paneleve qytetare ofron mundësi për dialog të drejtpërdrejtë ndërmjet qytetarëve dhe vendimmarrësve. Këto mekanizma lejojnë që qytetarët të shprehin shqetësimet e tyre, të propozojnë zgjidhje dhe të ndikojnë në proceset vendimmarrëse. Për shembull, Asambletë Qytetare janë një formë e tillë e angazhimit, ku një grup përfaqësues i qytetarëve mbledhet për të diskutuar dhe dhënë rekomandime mbi çështje specifike.

- **Inkurajimi i partneriteteve** me organizatat e shoqërisë civile dhe grupet lokale për të siguruar përfaqësim më të gjerë.

Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile dhe grupet lokale mund të ndihmojë në arritjen e segmenteve të popullsisë që mund të jenë të vështira për t'u angazhuar përmes kanaleve tradicionale. Këto organizata shpesh kanë lidhje të forta me komunitetet lokale dhe mund të shërbejnë si ura lidhëse ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve publike.

- **Sigurimi i edukimit qytetar** për të rritur ndërgjegjësimin mbi të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrjes.

Edukimi qytetar është thelbësor për të pajisur individët me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të marrë pjesë në mënyrë efektive në proceset demokratike. Kjo përfshin informimin mbi të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve, si dhe mbi mënyrat se si ata mund të angazhohen në proceset vendimmarrëse. Programet e edukimit qytetar mund të zhvillohen nëpërmjet shkollave, organizatave të shoqërisë civile dhe platformave online.

10. KONKLUZION & HAPA TË MËTEJSHËM

Pjesëmarrja qytetare është një element kyç i një demokracie të shëndetshme. Për të arritur një sistem më gjithëpërfshirës dhe efektiv, Kuvendi i Shqipërisë duhet të vazhdojë të investojë në mekanizma që inkurajojnë dhe lehtësojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje. Duke ndjekur edhe strategjitë dhe praktikatat e paraqitura në këtë dokument, Kuvendi mund të sigurojë vijimësi dhe qëndrueshmëri për pjesëmarrjen qytetare duke ndërmarrë hapa të mëtejshëm për:

- **Zhvillimin e strategjive të reja të angazhimit**, duke përfshirë mjete teknologjike dhe ndërveprime të drejtpërdrejta me qytetarët.
- **Monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm** të praktikave ekzistuese për të siguruar efektivitetin e tyre.
- **Zhvillimin e një raporti vjetor mbi pjesëmarrjen qytetare**, për të identifikuar tendencat dhe për të përmirësuar proceset ekzistuese.
- **Zgjerimin e bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare** për të ndarë praktikatat më të mira dhe për të përfituar nga përvojat e vendeve të tjera.

Duke implementuar këto hapa, Kuvendi mund të forcojë lidhjen e tij me qytetarët dhe të sigurojë një demokraci më gjithëpërfshirëse dhe efektive.

11. BURIME

Ky dokument u mbështet në burimet e mëposhtme, por mund të shërbejnë edhe si lexime të mëtejshme.

ARTIKUJ SHKENCORË & LIBRA:

- Bussu, S., & Galanti, M. T. (2022). *Deliberative democracy in public policy: Lessons from the Italian Citizens' Assemblies*. *Policy Studies*, 43(1), 22-40.
- Davidson, S., Elstub, S., Johns, R., & Stark, A. (2011). *Rating the debates: The 2010 UK party leaders' debates and deliberative democracy*. *The Political Quarterly*, 82(2), 304-313.
- Dryzek, J. S. (2010). *Foundations and frontiers of deliberative governance*. Oxford University Press.
- Elstub, S., Ercan, S. A., & Mendonça, R. F. (2021). *The fourth generation of deliberative democracy*. *Critical Policy Studies*, 15(2), 139-167.
- Muçollari, O., Çerekja, B., & Nezha, K. (2024). *Unveiling the Enigma: Empowering Citizen Engagement in Decision-Making Deciphering Albania's Case*. *Academic Journal of Interdisciplinary Studies*.
- Serra-Silve, S., Gaio e Silva, J. (2024). *Empowering the people. The evolution and impact of Portugal's citizens' legislative initiatives in a comparative perspective*. *Parliamentary Affairs*, XX 1-26.
- Warren, M. E. (2002). *What can democratic participation mean today?* *Political Theory*, 30(5), 677-701.
- Williamson, A., & Barratt, J. (2022). *Mapping deliberative democracy in the Council of Europe*. *European Journal of Political Research*, 61(3), 678-698.

BURIME NË WEB:

- Britannica. (2025). *Deliberative democracy | Political theory & practice*. <https://www.britannica.com>
- Go Vocal. (2024). *What is deliberative democracy? A comprehensive guide*. <https://www.govocal.com>
- Inter-Parliamentary Union (IPU). (2020). *Handbooks for parliamentarians*. <https://archive.ipu.org>
- Inter-Parliamentary Union (IPU). (2022). *Global Parliamentary Report 2022: Public engagement in the work of parliament*. <https://www.ipu.org/impact/democracy-and-strong-parliaments/global-parliamentary-report/global-parliamentary-report-2022-public-engagement-in-work-parliament>
- Inter Pares. (n.d.). *Inter Pares: Parliaments in partnership – EU global project to strengthen the capacity of parliaments*. <https://www.inter-pares.eu/en>
- Involve. (2018). *Deliberative public engagement: Nine principles*. https://www.involve.org.uk/sites/default/files/uploads/docuemnt/Deliberative-public-engagement-nine-principles_0.pdf
- OECD. (2024). *Eight ways to institutionalise deliberative democracy*. <https://www.oecd.org>
- Parliamentary Indicators. (2024). *The Parliament of Albania uses the indicators to guide its transparency and citizen engagement policies*. <https://www.parliamentaryindicators.org>

Scottish Government. (2024). *Participation handbook*. <https://www.gov.scot>

Scottish Government. (2024). *Participation handbook: A guide for public sector organisations*. <https://www.gov.scot/binaries/content/documents/govscot/publications/advice-and-guidance/2024/03/participation-handbook/documents/participation-handbook/participation-handbook/govscot%3Adocument/participation-handbook.pdf>

Scottish Parliament. (2022). *Citizen participation and public petitions committee report: The future of participation*. <https://digitalpublications.parliament.scot/Committees/Report/CPPP/2022/12/16/741396a1-57a0-4a7b-aa80-390adf7f287a-2#ca3ee1c6-ca16-412a-8d95-ebc5f3066aa4.dita>

WFD. (2021). *How deliberative processes could save democracy*. <https://www.wfd.org>

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim — IDM është një organizatë jo-qeveritare, e themeluar në nëntor të vitit 1999, që ka në fokus të veprimtarisë së vet qeverisjen pjesëmarrëse dhe institucionet demokratike, procesin e integritit në Bashkimin Evropian, zhvillimin e shoqërisë civile, bashkëpunimin rajonal dhe çështjet e sigurisë. Ne synojmë konsolidimin e zhvillimeve në këto fusha nëpërmjet hulumtimit të pavarur, rritjes së kapaciteteve dhe ndërveprimeve efikase përmes spektrit të gjerë të aktorëve në shoqëri.

Institute for Democracy and Mediation

Rr. Shenasi Dishnica, Nd.35, H.1, 1017

T: +355 4 240 0241 | C: +355 67 38 42 437

www.idmalbania.org